



Pranimi / Dorezuar Prillog / Predato Received / Delivery		02. 04 2021		viti god year
Organ / Mjesta Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity	
SKPMSHCV	1604/2021		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.87/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.87/2021 të datës 18.02.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Tringë Ismajli", nr.28/44, në Komunën e Prishtinës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën mars-dhjetor të vitit 2020, respektivisht kundër organit të punësimit Ministria e Infrastrukturës, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve të punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 01.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. ANULOHET** vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën prill-dhjetor për vitin 2020, i datës 09.03.2021 për ankuesin
- II. OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjnë rivlerësimin e rezultateve të punës për periudhën nga data 01.04.2020 deri me datën 31.12.2020 për nëpunësin civil
- III. OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar nw Ministrinë e Infrastrukturës sipas akt emërimit të datës 17.04.2012 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Rregullimit Ekonomik dhe Licencimeve", në Departamentin e Autoritetit të Aviacionit Civil/, është vlerësuar nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i tij konkretisht nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës për periudhën janar-mars të vitit 2020, me notën e përgjithshme 4.50 përderisa ka qenë në pozitën "Ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit të Autoritetit të Aviacionit Civil", ndërsa për periudhën prill-dhjetor të vitit 2020, ankuesi në pozitën "Udhëheqës i

Divizionit të Rregullimit Ekonomik dhe Licencimeve”, është vlerësuar nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë “Drejtori i Departamentit të Autoritetit të Aviacionit Civil”, me notën e përgjithshme 2.60.

Ankuesi, kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020, me datën 18.02.2021 ka parashtruar ankesën me nr. prot: 704/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që vlerësimi i rezultateve të punës është bërë pa mbajtur asnjë takim paraprak nga ana e mbikëqyrësit të tij, vlerësimi ndaj tij nga ana e mbikëqyrësit është jo real, i pa bazuar, tendencioz dhe diskriminues, si dhe pretendimi se për periudhën janar-mars është vlerësuar me notën 4.50 nga Sekretari i Përgjithshëm, ndërsa për periudhën prill-dhjetor është vlerësuar nga Drejtori i Departamentit të Aviacionit Civil me notën 2.60 në kundërshtim me Rregulloren për vlerësim Nr.21/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave ligjore në fuqi me datën 01.03.2021 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës. Me datën 11.03.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Infrastrukturës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 704/2021 të datës 18.02.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve të shërbimeve publike për periudhën janar-mars të vitit 2020 për pozitën “Ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit të Aviacionit Civil: Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve të shërbimeve publike për periudhën mars-dhjetor të viti 2020 nga Drejtori i Departamentit të Aviacionit Civil për pozitën “ Udhëheqës i divizionit të rregullimit ekonomik-Departamenti për Aviacionin Civil-Ministria e Infrastrukturës” ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Plani i punës - 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Plani i punës për vitin 2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2017; Plani i punës për vitin 2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2014; Aktgjykim me numër A.nr.971/15 i datës 06.03.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 01.03.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 11.03.2021 nga Ministria e Infrastrukturës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankuesit të kthehet në rivlerësim, sepse :

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të dëshmive të ofruara ka konstatuar se organi i punësimit lidhur me dorëzimin e formularit të vlerësimit, tek ankuesi, ka ofruar të dhëna që janë të ndryshme me deklaratimet dhe me pretendimet e palës ankuese, e që për Kolegjin është e pamundur të konstatoj se cila është e saktë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që ankuesi në ankesën e tij ka theksuar që formularin e vlerësimit për periudhën mars-dhjetor të vitit 2020, e ka pranuar me datën 25.01.2021, ndërsa në provat e dërguara nga organi i punësimit /Ministria e Infrastrukturës, në formularin e vlerësimit tek pjesa” komentet e të vlerësuarit në rast se është i pakënaqur me vlerësimin e objektivave dhe aftësive”, del se ankuesi këtë vlerësim e ka nënshkruar me vërejtje dhe mban datën 25.02.2021. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave po ashtu në formularin e vlerësimit të ankuesit, të dërguar nga organi i punësimit/Ministria e Infrastrukturës tek pjesa e dytë “Vlerësimi në bazë të objektivave/detyrave të punës/numri i objektivave/detyrave të punës dhe aktiviteteve.....”, ka gjetur se këto objektiva janë miratuar nga mbikëqyrësi/vlerësuesi i ankuesit me datën 09.03.2020, ndërsa tek vartësi/i vlerësuar mbajnë datën

09.03.2021, andaj mbi bazën e këtyre provave, Kolegji ka konstatuar se nuk ka arritur të kuptoj saktë datën se kur ankuesi e ka pranuar vlerësimin nga udhëheqësi i tij dhe se kur saktësisht e ka nënshkruar vlerësuesi formularin e vlerësimit për vartësin e tij respektivisht ankuesin, ngase në shkresat e lëndës del se kemi dy situata të ndryshme të provave të siguruara në njërin anë nga ankuesi dhe në anën tjetër nga organi i punësimit, e krejt kjo në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L - 114 për Zyrat e Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, respektivisht në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike thuhet se :*“Vlerësimi bëhet deri me 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak”*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, gjatë analizimit të provave të lëndës konkretisht formularin e vlerësimit të rezultateve të punës për ankuesin për periudhën janar-mars të vitit 2020 dhe prill-dhjetor të vitit 2020, ka gjetur se ankuesi për periudhën janar-mars të vitit 2020 është vlerësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës me notën e përgjithshme 4.50, sepse ankuesi gjatë kësaj periudhe ka qenë ushtrues detyre në pozitën e “Drejtorit të Departamentit të Aviacionit Civil”, ndërsa për periudhën prill-dhjetor është vlerësuar nga Drejtori i Departamentit të Aviacionit Civil me notën e përgjithshme 2.60, në pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Rregullimit Ekonomik dhe Licencimeve”. Kolegji me këtë rast ka konstatuar se për të njëjtin ankues gjatë një viti ka pasur dy vlerësime me nota të ndryshme, nga mbikëqyrës të ndryshëm. Lidhur me vlerësimin e ankuesit për periudhën mars-dhjetor të vitit 2020, Kolegji ka konstatuar se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit konkretisht Drejtori i Departamentit të Autoritetit të Aviacionit Civil, me rastin e vlerësimit të ankuesit me notën e përgjithshme 2.60, tek pjesa e komenteve për asnjë nga objektivat apo aftësitë nuk ka shprehur mendimin se pse është vlerësuar ankuesi me këtë notë, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm dhe ta jap mendimin lidhur me përmbushjen a po jo të njërit prej objektive dhe detyrave të punës, e krejt kjo është bërë në kundërshtim me Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe të Nëpunësve të Shërbimeve Publike, sepse vlerësimi është kundërtë në vetvete dhe po ashtu nuk korrespondon me vlerësim as përafërsisht të njëjtë për një (1) vit sipas notimit dhe komenteve të ofruara për përmbushjen e objektive nga dy vlerësuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me për vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën prill-dhjetor të vitit 2020 pa pasur asnjë takim paraprak nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës konkretisht, ka konstatuar se është i qëndrueshëm sepse nuk ka asnjë dëshmi që udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit në fund të periudhës së vlerësimit ka ftuar ankuesin për të diskutuar për realizimin e objektive dhe rezultateve të arritura, ashtu siç parashihet me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, i cili përcakton se: *“Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektive dhe i aftësive profesional të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: takimi për diskutimin e realizimit të objektive dhe rezultateve të arritura; vlerësimin (notimi) e objektive”*, po ashtu në provat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që mbikëqyrësi është takuar me ankuesin gjatë periudhës vlerësuese për të rishikuar progresin e bërë siç parashihet me nenin 43 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat e Publik dhe nenit 7 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se në bazë të provave të lëndës është vërtetuar se ankuesi nuk është vlerësuar drejtë lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020, respektivisht Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka vepruar në kundërshtim dispozitave të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, si udhëheqësin më të lartë administrativ që të ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi, ndërsa Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit në pajtim me të gjeturat e këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 për periudhën 01.04.2020 deri më 31.12.2020 për ankuesin


si dhe të gjitha procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t'i zhvilloj në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.87/2021

Ardita Perçuku-SHYTI


Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

